

LIGJI Nr. 05/L -090

PËR SPONSORIZIME NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SPONSORIZIME NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj rregullon përkrahjen dhe mbështetjen financiare e materiale të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive përmes sponsorizimeve dhe reklamave.
2. Përmes sponsorizimit të aktiviteteve të ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit realizohet interesi i përgjithshëm i cili sjell përmirësimin e jetës individuale dhe shoqërore të qytetarëve, organizatave biznesore, fondacioneve, personave fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës.
3. Qëllimi i sponsorizimit është realizimi, përkrahja, promovimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.
4. Sponsorizimi i jepet pranuesit për implementim të interesit të përgjithshëm publik nga aktivitetet i caktuar kulturor, rinor dhe sportiv, i definuar në marrëveshjen e sponsorizimit.
5. Ky ligj është në përputhshmëri me Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Evropian (version i konsoliduar), GZ C 326/74, datë 26.10.2012, dhe me Rregulloren e Këshillit të BE –së 2015/1588 (13.07.2015) mbi zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian për kategoritë e caktuara të ndihmes shtetërore horizontale, OJ L 248/1, 24.9.2015.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ky ligj rregullon:
 - 1.1. sponsorizimet që ipen dhe pranohen përmes mbështetjes financiare dhe materiale në kulturë, rini dhe sport;
 - 1.2. qëllimin e dhënies dhe pranimit të sponsorizimit;
 - 1.3. përcaktimin e dhuruesit dhe pranuesit të sponsorizimit;
 - 1.4. zbritje të lejuara që iu bëhen sponsorizuesve;

1.5. evidentimin dhe kontrollimin e sponsorizimeve në veprimtaritë publike dhe aktivitetet e ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Në këtë ligj shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1. **Sponsorizimi** – mbështetje financiare dhe materiale në bazë të vullnetit të lirë që jepet nga personat fizik apo juridik të vendit dhe të huaj me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Sponsorizimi mundëson sponsorizuesve të promovojnë emrat, bizneset, logot dhe produktet e tyre me qëllim të shfrytëzimit të zbritjeve të lejuara për sponsorizim dhe lehtësirat administrative dhe tatimore shtesë të përcaktuara me këtë ligj.

1.2. **Aktivitete** - veprimtaritë e ndryshme që mbështeten përmes sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

1.3. **Interes i përgjithshëm publik**– mbështetja e aktiviteteve të ndryshme në promovimin e kulturës, rinisë dhe sportit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

1.4. **Personi fizik i vendit**- qytetar i Republikës së Kosovës, taksa pagues i rregullt tatimor.

1.5. **Person fizik i huaj**- person i huaj me leje të rregullt qëndrimi në Republikën e Kosovës, apo që jeton në një shtet tjetër.

1.6. **Person juridik vendor**– institucion publik, njësinë e vetëqeverisjes lokale, shoqëritë apo asociacionet e qytetarëve dhe bizneseve, fondacionet nga interesi publik, shoqëritë tregtare, ndërmarrjet afariste, organin e administratës publike dhe subjektin tjetër i cili me regjistrim para organit kompetent ka fituar cilësinë e personit juridik.

1.7. **Person juridik i huaj** - çdo person fizik i cili ka firmë të regjistruar jashtë vendit ose nëse e ka të regjistruar firmën në vendin e tij në regjistrin e tregëtisë dhe në organizatat e huaja, fondacionet ndërkombëtare dhe në institucione tjera joprotabile.

1.8. **Promovimi** –vendosja dhe afirmimi i emrit, firmës dhe logos (emblemës) së dhënësit të sponsorizimit në mbështetje financiare të veprimtarive dhe aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.

1.9. **Reklama** – promovim i logos në fanela, në objekte sportive, kulturore, rinore, në radiotelevizione, gazeta, revista, portale, afishe, tiketa, billboard dhe ueb faqe.

1.10. **Ministria** –Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

1.11. **MF** - Ministria e Financave.

1.12. **ATK** –Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 4

Marrëveshja për sponsorizim

1. Dhënësi dhe pranuesi i sponsorizimit bëjnë marrëveshje në formë të shkruar lidhur me sponsorizimin e bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Marrëveshja për sponsorizim dhe reklamë duhet të përmbajë: detyrimet e sponsorizuesit, kompensimin, ekskluzivitetin, mirëbesimin, shkëputjen, përjashtimin e përgjegjësisë, dënimin kontraktor, hyrjen në fuqi, kohëzgjatjen, formën e shkruar, ligjet e aplikueshme dhe gjykatën kompetente.
3. Lënda e marrëveshjes nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nënkupton realizimin e interesit të përgjithshëm publik të caktuar me këtë ligj.
4. Për sponsorizimet në përputhje me këtë ligj, me kërkesë të dhënesit, pranuesi i sponsorizimit dorëzon vërtetim ose dëshmi për sponsorizimin e pranuar.
5. Forma dhe mënyra e përpilimit të vërtetimit apo dëshmisë si dhe procedura e leshimit të saj përcaktohet nga Ministria me akt nënligjor.

Neni 5

Format e sponsorizimeve

1. Me këtë ligj njihen këto forma dhe lloje të sponsorizimit përmes:
 - 1.1. ofrimit të mjeteve financiare përmes xhirollogarisë bankare të pagesës së shumës totale të sponsorizimit ose pagesës me këste, të cilat bëhen sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.2. ofrimit të paisjeve muzikore, sportive dhe rekuizita tjera,
 - 1.3. ofrimit të mbështetjes për pjesëmarrje në gara dhe përgatitjet tjera menaxhuese, artistike dhe sportive;
 - 1.4. ofrimit të shërbimeve të transportit, të akomodimit dhe ushqimit për pjesëmarrësit në aktivitetet e sponsorizuara;
 - 1.5. ofrimit të shërbimeve të sigurisë;
 - 1.6. ofrimit të shërbimeve të rregullimit të ambientit dhe infrastrukturës së nevojshme;
2. Reklama realizohet përmes kontratës së noterizuar mes palëve.

Neni 6

Llojet e sponsorizuesve

1. Sponsorizuesit janë: individual, bashkësponsorizues, personat juridik të vendit dhe të huaj të cilët sponsorizojnë aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive.
2. Bashkësponsorizues janë dy apo më shumë persona fizik ose juridik të bashkuar me qëllim

të mbështetjes të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.

Neni 7 **Orientimi në fushën e sponsorizimit**

Sponsorizuesi vlerëson varësisht nga interesi i tij/saj se në cilën fushë do të sponsorizojë në kulturë, rini apo sport.

Neni 8 **Kategorizimi dhe ndarja e sponsorizimeve**

Kategorizimi dhe ndarja e sponsorizimit përcaktohet me marrëveshje ndërmjet subjekteve të marrëveshjes.

Neni 9 **Elementet e Sponzorizimit**

1. Sponsorizues mund të jetë personi fizik dhe personi juridik vendas apo i huaj.
2. Sponsorizues nuk mundet të jetë personi fizik dhe personi juridik vendas apo i huaj, veprimtaria e të cilit është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare që Republika e Kosovës i ka nënshkruar apo iu ka bashkuar.

Neni 10 **Të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshja e sponsorizimit**

1. Përfituesi i sponsorizimit mund të jetë personi fizik apo juridik vendor i cili në emër të pranimit të sponsorizimit, duhet të realizoj detyrimet të cilat dalin nga marrëveshja e nënshkruar për sponsorizim.
2. Të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshja në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Kosovës i ka nënshkruar apo ju ka bashkuar.

Neni 11 **Shfrytëzuesit e zbritjeve të lejuara**

Sponsorizuesi dhe reklamuesi kanë të drejtë në zbritje të lejuara të përcaktuara me këtë ligj dhe legjisllacionin në fuqi.

Neni 12 **Zbritjet e lejuara**

1. Sponsorizuesit për sponsorizimet në aktivitetet e sportit u njihet zbritja tridhjetë përqind (30%) nga tatimi në fitim sipas këtij ligji.
2. Sponsorizuesit në sponsorizimet në fushën e kulturës dhe rinisë u njihet zbritja njëzet përqind (20%) nga tatimi në fitim në bazë të Ligjit Nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Koropratave.
3. Shpenzimet e reklamës në fanela sportive, objekte sportive dhe kulturore, përmes radios,

televizionit, gazetave, revistave, portaleve, reklama të drejtpërdrejta, ueb faqe, posterat, afishet, tiketat, billboardat, reklamat tranzite e të ngjashme janë shpenzime terësisht të zbritshme, për qëllime tatimore në përputhje me Ligjin Nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Kororatave.

4. Të hyrat nga sponsorizimet janë të hyra të pa-tatueshme për përfituesin e sponsorizimit.

5. Të hyrat nga reklamat janë të hyra të tatueshme për përfituesin e të hyrave nga reklamat, përjashtim nga kjo dispozitë bëjnë të hyrat nga reklamat që janë parashikuar në kontratën e sponsorizimit sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 13

Përjashtimet nga zbritjet e lejuara

Zbritjet e lejuara nuk mund të realizohen në rastet kur sponsorizimi ose reklama përdoret për aktivitete tjera që nuk janë të precizuara me marrëveshjen kontraktuale në mes të sponsorizuesit dhe reklamuesit që bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 14

Evidentimi dhe Kontrolli

1. Dhënësi dhe pranuesi i sponsorizimit janë të detyruar të përgatisin raport për sponsorizimin e dhënë dhe të pranuar i cili duhet të përmban këto të dhëna:

1.1. emri dhe titulli i dhënësit dhe i pranuesit;

1.2. emri dhe titulli i shfrytëzuesit të fundit;

1.3. përshkrimi i lëndës dhe qëllimit të sponsorizimit i cili mundëson identifikimin e tyre me të dhëna të sakta për sasinë, vlerën dhe vetitë tjera të tij;

1.4. përdorimi përfundimtar i lëndës së sponsorizimit;

1.5. të dhëna të tjera.

2. Marrëveshja për sponsorizim dhe reklamim me raportin financiar detyrimisht dorëzohet në ATK më së largu tredhjetë (30) ditë nga dita e përmbushjes-përfundimit të marrëveshjes.

3. Marrëveshja për sponsorizim, reklamim si dhe dokumentacioni tjetër i cili është i ndërlidhur me të duhet të ruhen më së paku pesë (5) vjet nga përfundimi i vitit kalendarik në të cilin është përmbush detyrimi nga marrëveshja.

Neni 15

Kontrollimi i shfrytëzimit të sponsorizimit

1. ATK - ja dhe organet kompetente mbikëqyrin dhënie, pranimin dhe shfrytëzimin e sponsorizimit dhe reklamimit për zbritjet e lejuara sipas këtij ligji.

2. ATK - ja dhe organet tjera kompetente, në qoftë se gjatë kontrollit vërtetojnë parregullsidhe

keqpërdorime gjatë shfrytëzimit të sponsorizimit mund të parashtrojnë kallëzime penale apo kundërvajtëse sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Mbrojtja e interesit publik

1. Me kërkesë të shfrytëzuesit të sponsorizimit, Ministria lëshon vërtetim në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës me të cilin vërteton se sponsorizimi në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është interes i përgjithshëm publik i përcaktuar me këtë ligj dhe sipas nenit 10 të Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

2. Ministria në afatin e paraparë, kërkon sqarim për secilën kërkesë të paraqitur, në bazë të kompetencave të veta nga organet përkatëse mbikqyrëse.

Neni 17

Sanksionet

1. Në shumën prej njëmijë (1.000) deri dhjetëmijë (10.000) euro dënohet për shkelje personi juridik – pranuesi i sponsorizimit, nëse:

1.1. nuk lidhë marrëveshje me shkrim me sponsorizuesin apo reklamuesin;

1.2. nuk ka përgaditur një raport për marrjen e sponsorizimit, reklam[s];

1.3. nuk i shfrytëzon mjetet sipas marrëveshjes, ndërsa lënda e sponsorizimit do t'i kthehet dhënesit të sponsorizimit;

1.4. marrëveshja dhe dokumentat e tjera nuk ruhen së paku pesë (5) vite.

2. Nëse sponsorizuesi fizik apo juridik falsifikon dokumentacionin apo mashtron Ministrinë apo ATK-në, dënohet konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 18

Aktet nënligjore

Ministria brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-090
23 dhjetor 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-007-2017, datë 13.01.2017 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.